

Më
 gjatë

12-03-2018

P.nr.720/2015

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër, [REDAKTUAR] nga Ferizaji rruga [REDAKTUAR] i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2487-2/14 të dt 15.06.2015, sipas së cilës e ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së duke vendosur rreth kërkesës për dhënie e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.28.09.2015 solli

AKTGJYKIM

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2487-2/14 të datës 15.06.2015, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari [REDAKTUAR] nga Ferizaji rruga [REDAKTUAR] i lindur me date, [REDAKTUAR], në fshatin [REDAKTUAR] Komuna Feriaj, nga i ati [REDAKTUAR], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal të letërnjoftimit [REDAKTUAR] mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt. 12.10.2014 rrethë orës 12:10, në Ferizaj në rrugën "Epopeja e Jezercit", duke drejtuar automjetin e tij të markës "Peugeot" me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 55 par.1 të LSKRR, nga pakujdesia duke mos e mbajtur distancën e sigurisë ndërmjet automjeteve e godet me pjesën e parë në pjesën e pasme automjetin e markës "Ford", me targa të regjistrimit [REDAKTUAR] të cilin e drejtonte [REDAKTUAR] nga Shtimja, ku posë dëmëve materiale lëndime trupore pëson [REDAKTUAR] nga Shtimja,-

- me të cilën kreu veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.1 të KPRK-së

- Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPK-së i shqipton

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarin [REDAKTUAR] i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Gjykata të dëmtuarin [REDAKTUAR], nga Shtimja, rr. [REDAKTUAR] pn.për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedural 50,66€ dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2487-2/14 të dt 15.06.2015 ka akuzuar [REDAKTUAR] nga Ferizaji rruga [REDAKTUAR] për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par pik 6 lidhur me par.I të KPRK-së dhe të njëjtën ditë ka parashtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor kundër të akuzuarit me arsyen se ka prova të besueshme që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i njëjti.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, në vështrim të nenit 414 par.I të KPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Nga provat materiale të bashkëngjitura në shkresat e lëndës gjyqtari ka lexuar ekspertizen e ekspertit mjeko ligjor i datës 02.06.2015, konstatimi i ekspertit të komunikacionit i datës 22.04.2015, lidhur me lëndimet e të dëmtuarit pandehurit e datës 12.10.2014, deklaratat e të dëmtuarit e datës 12.10.2014 dhe nga shiqimi i fotografive që gjinden në shkresat e lëndës ka konstatuar se këto prova janë të bazuara dhe bindëse, sepse vërtetojnë që i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par.3 të KPPK-së të dëmtuarin [REDAKTUAR] nga Shtimja, rr. [REDAKTUAR] pn.për, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 50,66 Euro, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ P.nr.720/2015 i dt.28.09.2015

Asistenti
Muedin Rexhepi



UDHËZIM JURIDIK:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotëfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.